



NJERIU PARAHISTORIK

nga prof. Sazan GURI

Historia e njeriut sipas historianëve fillon në të njëjtën kohë me aktivitetin e trurit të tij, gjë kjo që mendohet të ketë filluar gati 50.000 vjet të shkuara.¹

1.1 PARAHISTORIA

1.1.1 Ç'është parahistoria

Më parë se të shqyrtojmë kohën e lindjes dhe të zhvillimit të njeriut parahistorik, shtyhem të dëftojmë se ç'është parahistoria që veç gërvishjeve nëpër muret e shpellave nuk trashëgon aq fakte sa të arrish ta sendërtosh atë. Gjithsesi, ka disiplina si gjeologjia që arrin të përshkojë abisalet e milionave vjetëve, po për aq vite futet edhe në thellësitë e tokës, që mund të ndihmojnë kështu edhe arkeologë e historianë, pse jo edhe studiues të tjerë të analizojnë parahistorinë e pashkruajtur të dy milion vjetëve të fundit, por sidomos të 25,000 viteve të fundit.

Parahistoria është dega e shkencës, që merret me shpjegimin e fillimit të formimit të gjithësisë, të kushteve të lindjes dhe zhvillimit të jetës në tokë, të lindjes dhe zhvillimit të kores tokësore, kontinentet e tokës, etj. Parahistoria, pra merret me shpjegimin e dukurive në tokë deri kur fillon historia e njerëzimit. Historia e njerëzimit fillon at'herë, kur ajo fillon të shkruhet, dm.th. kur fillon rregjistrimi i shkruar, pra kur fillojnë dokumentet e shkruara, të quajtura shkrimet e para. Meqenëse, gjatë parahistorisë nuk ka dokumente të tilla nga dora e njeriut, sepse ky është kushti themelor i saj, të gjitha të dhënat që kësaj dege të shkencës i duhen, i merr nga fusha të ndryshme të shkencave të natyrës dhe të atyre shoqërore.

Dega e parahistorisë ndahet në disa nëndegë, siç është ajo që merret me studimin e lindjes së tokës, të lindjes së jetës në të, lindjes së kontinenteve, etj., por neve në rastin tonë kemi për qëllim trajtimin e parahistorisë njerëzore, çka lidhet qysh me kohën e gurlashtit (paleolitit), atëherë kur gjinia njerëzore shënon fillimin e shkëputjes nga primatët, klasa më e lartë e perandorisë së qenieve me ndërgjegje të ulët apo qenieve që kanë afsh (frymë) të thirura në zhargon kafshë. Fillimet shënohen mbi 2,5 milionë vjet më parë në Afrikën perëndimore, por Europa fillon të pushtohet nga njeriu në më shumë se dy milionë vjet më parë.²

1.1.2 Dy milion vitet e fundit

Për të folur për njeriun parahistorik, ndoshta do të ishte mirë të jepej një tablo për kushtet e motit që detyronin njerëzimin të mbledhje drejt mesdheut dhe gjene të hapej drejt veriut. Jemi ende larg formimit të racave, formimit të gjuhëve apo bashkimit të tingujve e bashtingujve për të formuar fjalët, sepse ezofagu nuk ka zbritur atje, ku ai ndodhet sot, i aftë të formësojë fjalën. Nga fillimi i Pleistocenit (dy milion vjet përpara), përkeqësimi i klimës që kishte filluar më herët, arriti një klimaks me akullnajimin kontinental të Pleistocenit, dhe kështu nga veriu i Europës brenda dy milion vjetëve të fundit kanë zbritur shtatë herë ose më shumë

¹ The Reader's Digest Association, *The last two million years*, fq. 16, v. 1973

² The Reader's Digest Association, *The last two million years*, fq. 18, v. 1973

akullnaja në formën e mbulesave të akullta me trashësi deri qindra metra, dhe sigurisht bashkë me to, edhe njerëzit e asaj kohe, si dhe komunitetet e kafshëve apo të bimëve.³

Ajo që mund të shënohet për këtë periudhë është se njeriu evolonte shumë shumë ngadalë, aq sa krahasohet me shembullin metaforik, se njeriut i është dashur 120,000 vjet vetëm të mbante penën me dy gishtat e njerës dorë. Deri në vitin 200,000, njeriu le të themi pak si egër, akoma nuk i kishte vajtur mendja të përplaste dy gurë stralli për të krijuar zjarrin. Madje, as nuk bëzante, sikur edhe një tingull apo zanore, por ndoshta shenjat dhe britmat si primatët e vet (majmunët) përbënin komunikimin e tyre.

Dhe vjen momenti. Natyra veprimi me ndryshimet e saj graduale, duke sjellë hopin (mbrekullinë), pikërisht në kapërxyellin e këtij momenti, (200,000 vjet para) njeriut i ndodh t'i zbrësë ezofagu nga prapa qafës në pozicionin që ne gëzojmë sot.⁴ Ky mund të jetë revolucioni më i rëndësishëm i parahistorisë njerëzore, sepse solli kushtin e parë të artikullimit të fjalës.

1.1.3 Akullnajimi i fundit (115,000 -18,000 vjet)

Akullnajimi i fundit (i quajtur Wisconsin në Amerikë dhe Wurm në Alpet europiane) filloi para 115 mijë vjetëve dhe arriti kulmin e tij rreth 18 mijë vjet më parë.⁵ Fiksoni fort shifrën e fundit, sepse këtu vjen ndryshimi njerëzor. Pas këtij kulmi, akujt u shkrinë me shpejtësi. Toka, në fakt kishte arritur pikën e saj më të ftohtë, rreth 22 mijë vite më parë gjatë të ashtuquajturit Maksimumi i Fundit Akullnajor, ku përkon me zhdukjen e njeriut para homosapiens, siç qe *Neandertali*, që ndryshe quhej nga njerëzit e asaj kohe si *i le apo i shpikur në andër*. Gjatë kësaj periudhe, temperatura mesatare globale mbi sipërfaqen e planetit ishte rreth 7 gradë celsius më e ulët se sa në fillim të akullnajimit. Kështu, u zbuluan zona të mëdha të shelfeve kontinental (sot nën ujë), duke bërë që shumë lumenj ta ndryshonin kursin e tyre, të paktën në pjesën e fundit të rrjedhës së tyre, dhe të derdheshin në det në zona që ishin shumë larg vendeve të derdhjeve të tyre të sotme.

Në Europë, gjatë maksimumit të fundit akullnajor, mbulesa akullnajore mbuloi të gjithë Baltikun deri në Danimarkë dhe rrafshinat veriore të Gjermanisë dhe të Polonisë, aty ku sot është Berlioni, duke lënë një alarm tregues shumë të qartë të zaptimit akullnajor. Në drejtim të lindjes, kufijtë e mbulesës akullnajore e quajtur Fenoskandiane mbuluan tërë krahinën veriore të Siberisë Perëndimore, përfshirë edhe Detin e Zi.⁶ Na duhet të vëmë theksin te Deti i Zi, sepse përgjat procesit të ç'akullnajimit kemi atë që mbahet mend nga homosapiensët, si përmbytja e madhe. Nga sa më sipër, kuptojmë se njerëzia në këtë periudhë e quajtur si epoka e paleolitit, ashtu së toku siç ishin, astrolopitek e neandertalas, sapiens e parasapiens, kanë zbritur drejt paraleleve jug i Francës deri në jug të Detit të Zi, me zemër të shtrirjes në pjesën e Egjeut apo të gadishullit Ilirik (Ballkanit të sotëm), por që me anë të krahasimit të formulave të gjakut të sotëm me atë fosil para 25,000 vjetëve, shkencës amerikane i rezulton se njeriu european zanafillon në Dardani⁷, madje ka teori që zanafillon nga zona pranë Durrësit.

³ MILANKOVIC, *Ndryshimet globale të nivelit të detit, sipas Sazan Gurit, te libri "Stratigrafia sekuenciale, fq.34, v. 2006*

⁴ *Dokumentar shkencor Kanadez në Explorer TV*


⁵ Peter VAIL et al, *Ciklet e ndryshimit global të nivelit të detit, fq.89, v. 1989*

⁶ Luan HASANI, Sazan GURI, *Ekologjia, fq.327, v.2012*

⁷ Sazan GURI, *Anthropologjia, Gazeta Nacional, Tetor, v.2015*

Fig. - 1 Geni shqiptar - E-V13!!! Kjo foto ilustron origjinën e gjenit E-V13. Ky gjen është gjurmuar mbrapa mbi 10'000 vite para Krishtit. Sic tregohet dhe nga studimet gjenetike të ilustruara në foto, origjina e këtij gjeni në Europë vjen nga SHQIPËRIA dhe ndaj ka marrë emrin GJENI SHQIPTARË! Përveçse fakteve historike që fqinjët tanë i përthyejnë sipas dëshirave, egzistojnë faktet gjenetike që nuk gënjejnë. Ne jemi popullatë e hershme kryesisht HOMOGJENE dhe jo popullatë e para 1000 vjetëve.

Jo rastësisht, kemi gjetje të tilla të jetesës në grupe nëpër shpellat apo sheshet e hapura në treva, edhe të Shqipërisë së sotme si p.sh.;



1. Paleosolet e pandryshueshme në kurrizin antiklinare të Kryegjatës, sipas akademikut M.Korkuti, kanë ruajtur dëshminë e aktivitetit të kësaj jete në parahistori. Këto gjetje datohen qysh në fillim të epokës së hershme akullnajore të fazës Vurm, pra, rreth 135,000 vjet më parë, kurse veglat e punës së Kryegjatës B i takojnë Paleolitit të mesëm⁸, pikërisht për kohën që po flasim (10-40,000 vjet përpara).
2. Shembull tjetër është rrëza e malit të Dajtit (Tiranë), ku janë zbuluar disa vegla stralli të epokës së Paleolitit të vonshëm (10-20,000 vjet).
3. Për jetesë paleolitike flasin dy stacionet të tjera, si ai i Xarës dhe ai i Shën Marinës.⁹
4. Në vitin 1982, spelologu shkodran e talent, G.Uruci zbuloi në shpellën e Gajtanit (Shkodër) shumë fosile të Kuaternarit.¹⁰
5. Në 1992-1994 në shpellën e Konispolit, u nxor në dritë një shtresë kulturore e Paleolitit të lartë, që provoi se kjo shpellë ishte përdorur për banim që në epokën e Paleolitit.¹¹
6. Popullimi i zonës në lindje të qytetit të Apollonisë dëshmojnë popullimin e saj që në epokën e Pleistocienit të vonë.¹²
7. Kërkimet u shtrinë edhe në territorin e Mallakastrës së butë, ku u zbuluan vendbanimet e Kryegjatës, e Krapësit, Peshtanit dhe Rusinjës, të cilat dëshmuar praninë e zonave banuese para epokës së Neolitit, gjë që nuk ishte konstatuar më parë. Nga kërkimi sipërfaqësor intensiv, në këto stacione janë mbledhur mbi 3000 copë vegla stralli të përdorura si dëshmi e aktivitetit të njeriut në këtë rajon.¹³

Pa u futur thellë në shtjellime që do të pasojnë, qysh në fillimet e këtij libri duket sikur ravijëzohet thënia e publicistit të sotëm Aleksandër Cipa se:

jemi këtu qysh para detit

⁸ Myzafer KORKUTI, Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri, fq. 21, v.2010

⁹ Po aty,

¹⁰ Gëzim URUÇI, Katalogu i tatuazheve të shqiptarët, Monografi, Gjermani, v. 2002

¹¹ Kristo FRASHËRI, Historia e qytetërimit shqiptar, fq. 4, v.2008

¹² Neritan CEKA, The illyrians to the albanians, fq 113, 2005

¹³ Teki SADIKU, Mallakastra dhe Myzeqeja e Vogël, fq.28, v. 2009

ose ta pranojmë, pa një pa dy, supersticizmin e rilindësve tanë dhe të shumë studiusëve të tjerë të huaj e të lashtë, si Pindari me shokë që thoshin se:

shqiptarët janë në këto troje, të lindur para hënës¹⁴

ose të kuptojmë, atë që me zë aq të lartë e thoshte poeti i shek. VIII p.e.r, Hesiodi që vinte nga një vendbanim pellazg, (Kimea e Azisë së Vogël), se:

pellazgët janë aq të vjetër, si të lindur nga vetë toka¹⁵

1.2. DALJA NË SKENË E PRIMATIT NJERËZOR (40,000 – 25,000 vjet)

1.2.1 Të parët e të parëve tanë

Homo erectus, lloji më i hershëm përfaqësues i klasës Homo, ishte i përhapur në Azi, Afrikë dhe Europë, rreth 500.000 vjet më parë. Në Angli dhe Gjermani janë gjetur fosile të Homo sapiens, të cilat tregojnë se specia jonë është shfaqur rreth 250.000 vjet më parë, ku kockat e tyre duken mjaft të ngjashme me tonat.¹⁶ Por është periudha rreth 40 mijë vjet më parë, ku pasardhësit e primatëve të hershëm ndryshuan dora dorës për të sjell njeriun modern. Vizatimet e gjetura janë bazuar në mbijetesën e fosileve të kockave, ku ato ekzistonin, por ngjyra e lëkurës, flokëve dhe syve janë thjesht spekulative. Edhe truri i njeriut u bë më i zhvilluar, duke iu përgjigjur kërkesave më komplekse të gjuetisë, njeriu u bë më i gjatë, me dhëmb dhe nofulla më të rregulluara.

1.2.1.1 Njeriu i neandertalit

Ishte njeriu që mbizotëronte në Europë pa ardhur mirë akullnajat, pas të cilave (25,000-18,000 vjet më parë), ata nuk mundën të mbijetonin. Koha solli në skenë ata më të fortit, më rezistentët, siç do ta shohim më poshtë. Njeriu Neanderthal, i cili u shfaq 700,000 vjet më parë dukej shumë i ashpër apo i pakëndshëm në krahasim me njeriun sot. Shkencëtarët besojnë se kafka e parë e Neandertal-it nuk ishte e zhvilluar. Por, ai ishte i pari, dhe ka meritën që përdori pa ndërprerje flakën që ishte baza e rregullave të dala më pas. Njeriu Neanderthal fliste, ndërkohë që ngrohej në shpellat e sigurta gjatë mbrëmjes.

1.2.1.2 Një tjetër krijues ka qënë Homo habilis - Njeriu me duar të gjata. Homo habilis ka jetuar rreth 1,750,000 vjet më parë. Truri i homo habilis ishte 680cc (cm³) dhe mendohet se ai ishte vetëm 105cm i gjatë. Për mijëra vjet, mjetet e punës të prodhuara nga guri u bënë më të përshtatshme dhe u përmirësuan, madje shumë.

1.2.1.3 Australopitheku – ashtu si edhe homo habilis, kishte një tru të vogël dhe ai mund të ecte e të qëndronte drejt. Njeriu modern erdhi rreth dy milion vjet më parë, pas “Njeriut 1470”. Ky ishte Homo erectus, “njeriu pothuajse i ngritur në këmbë”, specie e re e njeriut të epokës së Gurit, i cili jetoj rreth gjysëm milioni vjetë më parë. Ai ishte kryesisht në Azi, Europë dhe Afrikë, dhe përgjatë 200,000 vjetëve, kjo specie u përhap

¹⁴ Pindari, Carminia, Fragmenta Selecta, vol. I, fq. 240, Portando un bel dono, la Terra fece nascere per primo l'essere umano nell'ARCADIA, il “DIVINO PELASGO”, molto prima della luna.

¹⁵ Hesiodi, citim 700 vjet para krishtit, rreshtat e fillimit të Teogonisë 'Genesis of the Gods'.

¹⁶ The Reader's Digest Association, The last two milion years, fq. 24, v. 1973

në pjesë të tjera të globit. Në sytë e sotëm, ai dukej i shëmtuar. Ai kishte nofull të gjërë, dhëmb të gjatë dhe të mëdhenj, dhe balli i tij i ulët përfshinte vetulla të trasha. Por, truri i tij rreth 1000cc është më i përafërt me atë të njeriut të sotëm se sa të majmunit. Homo erectus vriste elefant, rinoceront, kuaj, dele, deve, derra, antilopa. Ndjekja e gjithë këtyre kafshëve kërkonte dinakëri dhe zgjuarsi, e cila favorizoi një rritje të madhësisë së trurit. Një njeri që gjuan i vetëm mund t'i nevojitej thjesht veprime të vogla, por të gjuante kafshë të mëdha, ai duhej të gjuante në grup. Kjo do të thoshte një disiplinë më e madhe, së bashku me mënyrat e komunikimit apo koordinimit të veprimeve. Gjatë kësaj kohe, me shumë mundësi, Homo erectus mund të ketë filluar të flas. Majmunët kanë një kuti zëri të aftë për të prodhuar fjalë si tinguj, por ata kurrë nuk kanë zhvilluar një qendër të foluri në trurin e tyre. Ishte pikërisht kjo kohë, kur mashkulli zhvilloi preferencën e tij për të dalë për gjueti, ndërsa femra për të ndenjur në shtëpi për të mbledhur të mbjellat dhe për t'u kujdesur për rritjen e fëmijëve. Homo erectus e përdorte zjarrin për t'u ngrohur dhe ndoshta për të gatuar. Gatimi, gjithashtu, ndoshta ishte një zbulim aksidental.¹⁷

1.2.1.4 Njeriu modern, homo sapiens edhe ky ka qenë pjesë e njeriut europian, dhe me shumë mundësi u zhvillua jashtë Europës, por në fillim qëndroi në Francë rreth 35.000 vjet me parë. Qysh në këtë periudhë, njerëzit përdornin kocka, drurin ose edhe gurin për të bërë vegla apo mjete të tjera që më pas i përdornin për gjueti.

Mbani mend

1. *Për një kohë të gjatë, procesi i fortë akullnajor dhe më pas mjetet e reja të punës nxorrën jashtë loje Neandertalin, dhe së bashku me ta dhe vetë homo sapiensin e ngathët, që në fakt zhdukja e tyre erdhi nga shumimi gradual dhe përthithja prej një njeriu të bërë dy herë sapiens ose e thënë ndryshe sapiens - sapiens.*
2. *Për 25,000 vjetët e fundit, homo sapiens sapiensi u bë i vetmi lloj njeriu të paktën në tokën europiane.*
3. *Në ciklin e fundit akullnajor, një racë si neandertali, austrolopiteku, etj., nuk ia dolën dot të mbijetonin;*
4. *Njerëzia, për shkak të të ftohtët u rrudh dhe iu drejtua mesdheut, përfshirë Afrikën e veriut;*

Kujdes!

Mesdheu, Egjeu dhe Afrika e veriut përbën shtëpinë e parë të madhe të njeriut parak, për të cilën do t'i ngelte mision historik zhvillimi dhe mbrojtja e tij.

Gjetje ose përfundime paraprake

1. Rreth 40 mijë deri 30 mijë vjet më parë, kur Evropën e kishin mbuluar akullnajat, në rajonet e trevave shqiptare sot apo parake europiane, si në Xarë (Sarandë), Kryegjatë (Fier), Gajtan (Shkodër), gjendeshin tehe stralli, si vegla për të nxjerrë rrënjë nga toka.
2. Në Shën Marenë (Sarandë), në Lanabregas (Tiranë), Kryegjatë (Fier), Gajtan (Shkodër)¹⁸ janë zbuluar vegla e mjete pune¹⁹ që na flasin se shoqëria njerëzore e at'hershme kishte bërë hapa përpara, p.sh:

¹⁷ The Reader's Digest Association, *The last two milion years*, fq. 18, v. 1973

¹⁸ Myzafer KORKUTI, *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*, fq. 14, v. 2010

¹⁹ Që Ilirët e kanë një prejardhje të lashtë në këto troje dhe se ne jemi pasardhës të denjë të këtij civilizimi, flasin shumë studime, jo vetëm të studiuesve shqiptarë, por numri më i madh i tyre është nga ata të huajt. Në suazat e shkencës së mirëfilltë, teoria tanimë e dëshmuar e prejardhjes së shqiptarëve të sotëm nga ilirët e lashtë, askund nuk diskutohet. Gjurmët e para materiale dhe

Ajo kishte zhvilluar gjuhën dhe ishte lidhur më ngushtë me punën.

1.2.2 Cikli i fundit akullnajor: 30,000 – 19,000 vite më parë

Rreth 30 mijë vite më parë, faza më e ftohtë e akullnajimit filloi në shkallë globale (ka mundësi, jo kudo menjëherë), dhe e arriti kulmin e saj gjatë të ashtuquajturit ‘Maksimumi i fundit akullnajor’, i cili ndodhi 23 deri 19 mijë vite më parë.²⁰ Përveç ngushticës së Beringut, i lokalizuar midis Siberisë dhe Alaskës, zona të tjera, që më parë mbuloheshin nga ujëra të cekët, tani u bënë pjesë e botës tokësore. Më në fund, rreth 19 mijë vjet më parë filloi të ngrihet niveli i detit, dhe në të njëjtën kohë filloi të ndodhë procesi i shkrirjes që do të përfundonte 7500 vite më vonë me hyrjen përfundimtare të tokës në ndër-akullnajimin e sotëm të Holocenit apo epokës njerëzore (antropogjene).

Përveç kulmeve të të ftohtit kulminant, që vazhduan pas ngjarjeve Heinrich, gjatë Akullnajimit të Fundit, ndodhën gjithashtu edhe rreth 20 kulme të ngrohjes, të cilat njihen me emrin “Episodet e Ngrohja”.

Shkaqet

- Shkrirja e shumicës së mbulesës së akullit në Hemisferën Veriore filloi nga 20 deri 19 mijë vite më parë²¹ dhe më në fund, mbaroi rreth 8 mijë vite më parë, kur mbulesat e akullit (afërsisht) arritën volumin dhe zgjerimin, ku ato janë sot.
- Përveç këtyre, studimet e sotme të evolucionit të sedimenteve bregdetare u kanë dhënë mundësi ekspertëve të vlerësojnë tre periudha të shkrirjes së ujit.²² Ne akoma nuk e kuptojmë plotësisht, përse këto tre periudha të mëdha të shkrirjes së akullit ndodhën gjatë procesit të ç’akullnajimit²³.
- Një shkak është se rreth 12 mijë vite më parë, kemi një ngjarje ngrohëse ‘Bolling-Allerod’, dhe pas saj, klima e Evropës kaloi (zbriti) edhe njëherë në një erë të re të ftohti, që njihet me emrin Dryas-i Ri.
- Së fundmi, prania e mbetjeve terrigjene të ardhura nga ajsbergët dhe të depozituara në dyshtemenë e detit në gjerësitë gjeografike mjaft të ulëta, (pranë territorit tonë) provon ftohjen e menjëhershme të ujit midis 12.9 dhe 11.6 mijë vjet më parë. Një anomali e këtyre ngjarjeve ndodhi midis 8400 dhe 8000 viteve më parë, me një kulm të të ftohtit rreth 8200 vite më parë.²⁴

1.2.2.1 Parahistoria e Evropës

më të vjetra të pranisë së jetës në këto troje, janë zbuluar në fshatin XARRË (afër Sarandës). Këto janë: vegla pune, armë, stoli, enë nga dheu, etj. Prejardhja e tyre daton që nga koha e paleolitit të lartë, që vazhdon afërsisht 40.000 - 6.000 vjet para erës sonë. Po ashtu është interesante zbulimi në shpellën e SHËN MARINËS (në Bogaz të Konispolit) të eshtrave të një dhie të egër, e cila i takon llojit "CAPRA IBEX", lloji i cili është zhdukur dhe nuk ekziston më, gjë që dëshmojnë mbi ekzistimin e lashtë të jetës në këto troje, me një gjueti të zhvilluar.

²⁰ Luan HASANI, Sazan GURI, *Ekologjia*, fq.310, 2012

²¹ Clark, v.2009, *Referencë nga libri “Ekologjia” me autor L. Hasani e S. Guri*, v.2012


²² ISHU, Fairbanks, 1989, Edwards, 1993, *Referencë nga libri “Ekologjia” me autor L. Hasani e S. Guri*, v.2012

²³ Goldblatt et al, (2006). *Bistability of atmospheric oxygen and the the Great Oxidation*, *Nature*, 443, 883 – 886.

²⁴ Sazan GURI, *Ngrohja Globale*, fq.155, 2015

- *Bifasët e parë në Evropë* – i quajtur ndryshe njeriu i shpellave, ka banuar në zonën bregdetare të Adriatikut 160,000 vjet më parë, si te shpella e Kaprinas, (në Kroaci, sot), të cilët përdornin zjarrin, vatrat e para, etj.
- *Paleolitiku i mesëm* - gjurmë të para të zbuluara në Gajtan, rrëzë malit Dajti, Xarë, Shën Mëri (Jug).
- *Paleolitiku i hershëm* - shfaqja e homo sapiens (rreth 35,000 vite më parë). Njeriu i parë evropian, që ne sot themi, ata të ardhur prej thellësisë së historisë *pe larg – pellazg*, mendoheshin Pellazgët, të cilët ushqeheshin me farat e lisit ose ishin ngrënës të lëndëve të lisit. (Fig. – 2)
- *Periudha pas akullnajore* - fillimet e bujqësisë dhe drithërave rreth 6500 vjet para krishtit. Zona mesolitike të zbuluara në Shqipëri në Blaz 1, Treni, Spileja.
- *Neolitiku* - 8000-3000 vjet, koha që stërgjyshërit shqiptarë banonin në rajonin e Kretës dhe Azisë së Vogël, shumë më parë periudhës Eneolitike 3000 – 2000 vjet, siç e dëshmojnë dhe gërmimet në Maliq, Kamnik, Nezir, Hisar, Ohër, Troja I dhe II.
- *Neolitiku* – 5000 - 4000 vjet para krishtit, koha që zë vend shfaqja e ndërtimeve megalitike në europën perëndimore.
- *Eneolitiku* – rreth 2000 vjet para krishtit, epoka e bakrit, kohë gjatë së cilës ndodh zbutja e kalit, prodhimi i verës në Evropën juglindore.²⁵
- *Antikiteti i hershëm*-epoka e Bronzës – shfaqja e shkrimit të mbiquajtur Linear A, ku datojnë zbulime objektsh prej epokës së mbiquajtur mikeniane (*thika, sëpata, maska, kordha, vazo ...*).

Fig. - 2 Koha, kur njeriu, dy herë sapiens i mbijeton të ftohtit të madh dhe fillon e zotëron botën. (Mirënjohje The Reader's Digest Association, The last two milion years).



1.2.2.2 Popullimi i globit

Për 20,000 vjetët e fundit, homo sapiens sapiens u bë i vetmi lloj njeriu në tokë. Është pikërisht kjo kohë që ky tip njeriu, më sakt njerëzimi, u nda në katër raca, të cilat njihen edhe sot. Tre grupet kryesore janë *Kaukazët*, të cilët kishin sendërtuar dhe gjuhën përkatese. Ata flisnin pothuaj Europiançen e stërlashtë, e cila si do ta shohim në gjithë kapërxyellet e kapitujve të këtij libri, zbërthehet me shqipen e sotme. Racë tjetër ishin ato Mongoloide (*aziatikët, indianët amerikanë*), dhe Negroidët.²⁶

Gjetje dhe/ose përfundime paraprake

Më shkoqur, i dashur lexues, njerëzimi ka thjesht tre raca:

1. Pellazg, arianë ose të bardh si ar;

²⁵ *Që njeriu të ketë pritur kaq gjatë për të zbutur kafshët, si qenin 8000 vjet para, kalin 2000 vjet, nuk na i do mendja se mund të jetë pikërisht kështu. Ndërkohë që dokumentarët e sotëm shkencorë vertetojnë se kafshët kanë qenë bashkudhëtarë të njerëzimit qysh në agimet e tij. Me patjetër që njeriu i ka pasur pranë kafshët e shtëpisë qysh kur njeriu filloi aktivitetin mbi natyrën pas shpikjes së zjarrit, kur gjuante në grup, etj., dhe më pranë akoma të paktën pas daljes prej shpellave 12,000 vjet përpara, por jo 2000 vjet para krishtit.*

²⁶ *The Reader's Digest Association, The last two milion years, fq. 19, v. 1973*

2. Të zinjë,
3. Të verdhë.

Kaukazoidët

Këta janë vëndasit e Europës. Ata, gjithashtu përfshijnë Hamitet dhe Semitet në Afrikën e Veriut dhe Arabi, dhe gjithashtu shtrihen më në lindje drejt Indisë. Ata kanë lëkurë dhe sy të bardhë. Kanë buzë të holla dhe hundë të vogël. Flokët e tyre, zakonisht janë të drejta ose me onde. Ky është njeriu parak europian, që d.t.th njeriu që:

1. i shpëtoi të ftohtit të madh;
2. diti të ruante zjarrin apo vatrën;
3. diti të vlerësonte gurin e strallit;
4. vlerësoi dritën, diellin.

Jo rastësisht, ky njeri, siç do ta shohim rëndom në faqet e këtij libri betohej, sikundër sot, pikërisht për gur e për vatër zjarri, po aq edhe për diell.²⁷

Është momenti që ky parak i bërë popull apo komb mori detyrën apo misionin për të ngjizur protoplazma të kombeve apo popujve të tjerë, siç do ta cekim në faqet e këtij libri.

1.2.2.3 Banesat e para

Rreth 30,000 vjet më parë, njeriu mori një hap revolucionar përpara. Në muret e shpellave me kohë janë gjendur dëshmitë e para që kanë mbijetuar nga përzgjedhja me paramendim e njerëzve për të shprehur ndjenja të forta me anë të pikturës. Është koha, kur i ftohti polar kishte zbritur pothuaj në veri të Egjeut, bashkë me të edhe njerëzit me gjënë e tyre të gjallë. Banesat e para të tyre, tashmë ishin shpellat, vendi ku banonin arinjt e pëllumbat e egër. Ndaj, edhe shumë shpella te ne (Gajtani, Treni, Skorrana në Erzen, etj.) ende quhen shpella e ariut ose shpella e pëllumbave, sepse në to gjenden jashtëqitjet e tyre dhe më pas ato të njerëzve.²⁸ Termi shpellë mund të jetë fjala e parë e njeriut parak europian, që gjën shpjegim nga pikëpamja etimologjike vetëm me anë të shqipes *si vend që s'pe*. Prej saj, buroi edhe fjala tjetër që lidhet me banimin, mbasi paraku europian doli nga *shpella*, dhe e quajti atë *shpi*. Po prej kësaj fjale mund të ketë ardhur edhe fjala *shpejt*, nga ajo që njeriu, kur bubullinte e vetëtinte apo binte shi, etj., i drejtohej banimit të vet, si vend shpëtimi *shpejt e shpejt*, prej së cilës rrodhi edhe fjala keltishte *speed*.

Gjetje dhe/ose përfundime paraprake

Duke qenë se sekuencat e akullnajimit (të ftohtit) dhe ç'akullnajimit (të ngrohtit) zgjasin rreth 42,000 vjet sipas cikleve të Milankovicit,²⁹ dhe epoka e të ngrohtit zë pjesën më të madhe të këtij cikli, mendohet se ajo e të ftohtit duhet të ketë zgjatur deri në vitet 10-12,000 vite para krishtit. Kjo kohë përkon me daljen e njeriut nga shpella.

1.2.3 Ngjarjet e mëdha të natyrës

²⁷ SHNEIDER, Për tokën dhe diellin, si perëndi, edhe sot ekzistojnë disa betime popullore, p.sh: më zëntë sytë kjo tokë, për atë diell që vete lodhur e këputur, më març hakën o symadh që i sheh të gjitha, etj. Diell-o diell-o, ama buc e miell-o.

²⁸ Perikli QIRIAZI, Shpella e pëllumbasit, Gryka e Skoranës, Tiranë.

²⁹ Sazan GURI, Stratigrafia sekuenciale, fq.25, v. 2006

1.2.3.1 Ngjarja e dytë kataklizmo e natyrës 12,000 vjet para kr.

Dhe mbas daljes prej shpelle, njeriu parak europian që ndoshta deri në këtë moment nuk ishte pagëzuar ende, del në qiell të hapur ndeshet me natyrën dhe me nevojën për kërkim, tashmë në grupe më të mëdha. Por, në memorie ruante gjëmën që i ndodhi prej të ftohtit të madh. Dhe nuk i mjaftoi kjo ‘reminishencë’ e së kaluarës, ai (njeriu parak) u ndesh me një ngjarje po aq të madhe, siç ishte hiri vullkanik që ka mbuluar një pjesë të mirë të rruzullit rreth viteve 12,000 para k.³⁰ Pra, njeriu parak, mbas kësaj ngjarje prodhoi një njeri tjetër apo bëri të delte mbinjeriu, i “vojtur”, por më i ditur.


1.2.3.2 Ngjarja e tretë kataklizmo e natyrës 9,000 vjet para kr.

I ftohti intensiv i akullnajimit u shoqërua në nivel global nga një shkallë e madhe ariditeti, për shkak të ngadalësimit të ciklit të ujit. Madje, edhe zonat e anëve të lumenjve në Mesdheun verior u mbuluan me një vegetacion të thatë (stepe). Mbulesa e fundit akullnajore u shkri 11.5 mijë vite më parë.³¹ Besohet se temperatura mesatare e sipërfaqes së Tokës gjatë Holocenit ka mbetur tek 14-15 gradë celsius, me përjashtim të disa periudhave të shkurtra të një ftohjeje të menjëhershme, e tillë si ftohja e papritur që ndodhi 8200 vite më parë. Në fakt, Toka kishte filluar të përfshihej 9000 vite me parë nga një periudhë e ngrohtë (Hypsitherma), e cila arriti kulmin rreth 6000 vite më parë. Kjo ka bërë shkrirjen e akujve dhe rritje të nivelit të detit, aq sa Egjeu u derdh furishëm në Detin e Zi dhe kemi atë që quhet përmbytja e madhe. (Fig. – 3) Kjo përbën mbijetesën e tretë të parakut European që e detyron atë të studiojë natyrën, botën dhe lëvizjet e kafshëve, si dhe astrologjinë si pozicionet e yjeve, rolin e diellit, të hënës dhe ligjet midis tyre.

Fig. – 3 Deti i Zi, me ngjyre blu të hapët - zonat e thata e më vonë të përmbytura (Mirënjohje Luan Hasanaj nga libri Ekologjia).



Është koha që i dhanë emër vetes si njerëz që vinin nga larg, më sakt *pelarg*, prej thellësive të mijëvjeçarëve të mbijetesës. Njëherësh vinin prej shpelle, më sakt *pe spele* (prej andej nga s'pe) që fare mirë mund të quanin veten ose të tjerët mund t'i thërisnin si shpellar. Aq të lidhur ishin me banesën e parë (jo pak, por rreth 15,000 vjet në to), sa edhe banesën në qiell të hapur e quajtën, si sot e kësaj dite *shpi* nga *shpell*. Nuk gjen, sikur edhe një komb tjetër, që vendi i banimit të ketë të njëjtën emërtesë me atë që quhet edhe banesa e parë e njeriut sikundër ka qenë shpella.



Gjetje dhe/ose përfundime paraprake

- Nga sa më sipër kuptojmë se ekzistokërka një popull apo një komb që ende e thëret banesën e vet si 25,000 vjet më parë.

- Mendohet se për 3000 vjet rrjesht, njerëzia e at'hershme, paraku europian, por tashmë me emër pellazgu, studiuan njëherësh si botën lart në qiell dhe ligjësitë e natyrës këtu në tokë, le të përmendim largësitë apo distancat midis yjeve, tokës, duke ndërtuar kalendarët e parë, teoremat si ajo e Pitagorës, që një nga një do t'i shohim në këtë libër. (Fig.- 4)

Fig. – 4 Modeli i gjeodetit që shkon sipas një modeli yllor te Argos. (Mirënjohje Robert TEMPLE³²)


1.2.3.3 Periudha e Holocenit (10,000 vjet para kr.)

Stacioni mezolitik i Kryegjatës është më i studiuar, e rrjedhimisht më i rëndësishmi për të njohur këtë epokë në vendin tonë.³³ Njerëzit bënë dhe riparimin pajisjet e gjahut, materialet prej druri, kocke, lëkure, etj. Në aspektin kohor, aktiviteti mezolitik i Kryegjatës përkon me epokën e Holocenit të hershëm, 11,700 vjet më parë, me një kohëzgjatje një ose dy mijë vjeçare. Pikërisht, 10 mijë deri 7 mijë vjet para erës sonë, njerëzit filluan zbutjen e kafshëve dhe mbjelljen e bimëve. Konispoli dhe Kryegjata me zbulimet e bëra tregojnë se qenë kryer hapat e parë drejt blegtorisë dhe bujqësisë primitive, ku periudhën e lulëzimit të vet, bashkësia primitive e pati gjatë neolitit dhe vazhdoi rreth 4 mijë vjet (7 mijë deri 3 mijë vjet para e.s).

Në kërkime pa fund të jetesës së përditshme

Jeta e njeriut bëhet më e lidhur me kërkimin e përditshëm për ushqim. Duke qenë se masat e akullit u tërhoqën 12.000 vjet më parë, u rikthyen pyjet dhe njeriu lëvizi drejt zgjerimit, ku filluan të përdonin metoda të reja për gjuetinë në ndjekje të kafshëve të ndryshme. Ai, nuk jetoi gjithmonë nëpër shpella, por në disa periudha dhe në disa sezone, ai mund të preferonte për ta bërë këtë, sepse shpellat ishin të ngrohta gjatë dimrit dhe të freskëta gjatë verës.

Fig. - 5 Shpella e Pëllumbit Tiranë, sikundër shumë shpella të tjera në Shqipëri që përgjat ciklit akullnajor, njeriu zboi arinjtë dhe pëllumbat prej tyre për jetesën e gjatë përmbi 12,000 vjet në këto shpella, aq sa kur doli prej tyre gjatë ngrohjes, banesën e quajti shpi, nga shpell, spe, shpai, shpi shtëpi, spital, hospiti, etj.



Mos u çudisni kur të përshkruajmë në këtë libër:

- pse piramidat e egjiptit flasin shqip;
- pse emrat e perëndive egjiptiane, siç vërente Xhusepe Katapano, përkojnë dhe zbërthehen me ato të shqipes;
- pse Aleksandri i madh shkoi pikërisht në ato zona që kishte prejardhjen raca e tij ose të parët e tij ose pushtoi aq toka sa ishte shtrirja e të parëve të tij;
- pse shqiptarët përgjat bashkëpunimit me otomanët luftonin për aq treva sa zotëronin në fillimet e tyre;

1.2.3.4 Një episod përjashtues 8200 vite më parë

³² Robert TEMPLE, *The sirius mystery*, fq. 162, v.1998

³³ Myzafer KORKUTI, *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*, fq. 14, v. 2010


Pjesa e parë e Holocenit pati një numër periudhash aride, gjatë të cilave ndodhi një rënie e menjëhershme e niveleve të ujit në liqenet e Afrikës, dhe po kështu, edhe e temperaturave globale. Kjo ndodhi na kujton se historia e klimës gjithmonë shënohet nga ngjarje të çuditshme. Një anomali e këtyre episodeve ndodhi midis 8400 dhe 8000 viteve më parë, me një kulm të të ftohtit rreth 8200 vite më parë. Saharaja dhe fqinja e saj Saleh nuk ishin toka rërore, ashtu siç ne i njohim sot, por ishin zona që përjetuan periudha të zgjatura me lagështi dhe që kishin liqene e kënetat të shumta që më vonë janë tharë. Në Nubia, (e lokalizuar në Egjiptin Jugor), janë gjetur piktura në shpella, ku janë vizatuar elefantë.³⁴ Dhe shumë larg nga brigjet e Nilit në një krahinë, e cila sot është e mbuluar nga shkretëtira, janë gjetur edhe mbetje paleontologjike të lepujve dhe gazeleve. Disa monumente me gurë të mëdhenj ciklopik të kësaj kohe tregojnë ekzistencën e një kulture të rëndësishme në një zonë, e cila sot është hiper-aride. Reshjet e shiut u zvogëluan rreth 5500 vite më parë, dhe rreth 4500 vite më parë, Saharaja pati një klimë të ngjashme me atë që ka sot, gjë që çoi në një densitet më të madh të popullatave në brigjet e Nilit dhe në lindjen e civilizimit Faranoik.⁶³ Pak studime që janë përqëndruar në krahinën jugore të Afrikës, gjithashtu sugjerojnë se pjesa e parë e Holocenit, periudhë që zgjati deri rreth 5200 vite më parë, ishte më e ngrohtë dhe më humide se sa pjesa e dytë e tij. Pastaj, rreth 3200 vite më parë, klima ndryshoi në një mënyrë të menjëhershme, duke u bërë shumë e thatë dhe më e ftohtë. Vonë vonë, në vitet 200 para krishtit, klima ngrohet prap, aq sa grekët nëpër olimpiada dhe romakët në beteja visheshin me një pëlthurë të lehtë, çka na tregon kohën e daljes në skenë të tyre.

Mbani mend:

Kjo histori paleoklime apo gjeologjie përputhet:

- me tregimet e Biblës,
- me lulzimin dhe rënien e perandorisë Sumere,
- me nisjen e epokës egjiptiane,
- me një racë njerëzore e mbijetuar nga tallazet e klimës së ftohtë, hiperaride, di të ngrejë mure apo monumente ‘megalithe’ (i madh e i lidhur) ose me gur ciklopik.³⁵ (Fig. – 6)

Fig. – 6 Muret pellazgjike të kalasë së Coldronit (fisi Sellëve apo Selijeve) rrëzë malit të Tomorrit, gjithë krahina e Gramshit, ku gëlojnë familjet me mbiemrat Zela, janë vazhduesit e këtij populli.



1.2.3.5 Përmbytja e dytë në Europë – ngjarje tjetër kataklizmo

³⁴ Sazan GURI, Ngrohja globale, fq. 158, v. 2015

³⁵ Le të përmendim murin rrethues të Akropolit të Athinës, ku të vjetrit e kanë quajtur pellazgjik dhe që është ndërtuar në mijëvjeçarin e tretë nga pellazgët. Ndërtimin e mirë, athinasit (bëhet fjalë, kur grekët ishin akoma larg nga skena e historisë) ua besuan pellazgëve, sepse ata ishin mjeshtërit e gurit dhe të murit, (të trashëguar te dibranët apo mokraret apo oparakët, sot), dhe dalloheshin midis popujve të tjerë. Akropolin që ndërtuan pellazgët “ishte punuar mirë” dhe i shërbente qëllimit, ndërsa ai i pari ishte “i keq” dhe “i pavlefshëm” shprehen studiist. Për ndërtimin e tyre, ndërtuesit kanë përdorur vetëm gurë të mëdhenj e mesatarë të papunuar (pagdhendur) të vendosur njëri mbi tjetrin, pa ndonjë rregull të caktuar dhe pa hedhje llaçi. Ndërtues të këtij stili kanë qenë vetëm pellazgët. Por, mure të tilla janë gjetur në Margëlliç, Gurzezë, Dimal, Mbjeshevë, Sfir, Kalenjë, Usojë, Bylis, etj.

Ndryshimet e Europës gjatë Holocenit të Mesëm janë më pak spektakolare se sa ato të krahinave tropikale. Ka mundësi që fenomeni më i rëndësishëm i kësaj periudhe të jetë vërshimi (përmytja) e papritur e Detit të Zi, e cila ndodhi afërsisht 5500 vite më parë. Në teori, në një fare kohe para 5500 viteve, klima e Europës jugore përjetoi një periudhë të ftohti dhe aridifikimi. Këto ndryshime nxitën rënien e niveleve të ujit në Detin e Zi, ndërsa në të njëjtën kohë u prish kontakti detar me Mesdheun, dhe ai u kthye në një liqen i zhytur me ujë të freskët. Pastaj, një rritje e vogël e nivelit të ujit në Mesdhe i lidhi përsëri të dy detet nëpërmjet Bosforit. Për shkak se sipërfaqja e Mesdheut ishte shumë më lartë se ajo e detit të Zi, me shpejtësi erozioni e ktheu çarjen e vogël, që ishte hapur në një ujëvarë të madhe me ujë të kripur. Kjo teori mund të shpjegojë shfaqjen e papritur të molusqeve halofile në kampionet me sediment nga Deti i Zi nga këto vite. Për një mijë ditë me radhë u derdh në liqen një rrymë e madhe uji, 200 herë më e madhe se sa Ujëvara e Niagarës, duke e ngritur nivelin e tij me 150 metra. Gjate episodit, ngritja e nivelit të detit ishte 15cm/ditë dhe bëri që vija bregore në disa zona, të kapte qindra metra për një ditë³⁶. Kohët e fundit, me ndihmën e robotëve nënujorë, oqeanografi Robert Ballard gjeti tregues të popullsive të hershme njerëzore në zonat që tashmë janë të mbuluara nga Deti i Zi.

Mba mend:

1. Është kjo përmytje e botës që i dha shtysë përhapjes të bujqësisë, fillimisht përreth Detit të Zi në këmbë të maleve Kaukaz, pranë një hapësire territoriale e quajtur Ararat.
2. Vonë vonë, profesioni bujk apo arapunues u përhap në drejtim të Europës qendrore, për shkak të emigrimit të popullsive që më parë banonin brigjet e liqenit.
3. Duhet thënë se nuk është spekuluar me atë që kjo katastrofë natyrore të jetë burimi mbi mitin e ‘Përmytjes së Madhe’.

Gjithsesi, ju kujtojmë se:

1. Prof. Gjusepe Katapangu thotë se "Atlantida e zhdukur para 12.000 vjetëve, ishte tokë e Ilirëve (Pellazgëve), që shpëtuan nga përmytja e Atlantidës dhe filluan civilizimet e reja në të gjitha kontinentet, sidomos në Europë, Afrikë dhe Azi të vogël".³⁷
2. "Atlantida" ka edhe një shpjegim etimologjik vetëm në gjuhën shqipe, që do ta përpunojmë më tutje... po ashtu ajo quhej edhe "Borei", që d.m.th. "e Bardhë", nga fjala shqipe 'Borë – dëborë'.
3. Hiri vullkanik që mund të ketë ndikuar në zhdukjen e një popullsie të madhe dhe mbijetesën e atyre të quajtur parakë, sipas shkencës së sotme ka ndodhur aty rreth 12,000 vjet më parë.

1.2.4 Epoka e Neolitit ose e Gurit të Ri (8000 – 5000 vjet para k.)

1.2.4.1 Njeriu zotërues i natyrës

Është koha, kur njeriu nga skllav i natyrës kthehet në zotërues të saj, ndaj quhet edhe epoka e fillimit të qytetërimit. Karakteristikë të epokës janë lindja dhe zhvillimi i bujqësisë e blegtorisë, si forma të rëndësishme të prodhimit. Neolitit i takon zbulimi i qeramikës, përgatitjes së enëve prej balte, i tjerres dhe endjes, si dhe përsosja e mëtejshme e teknikës së punimit të veglave prej guri e kocke. Kultura e neolitit të hershëm është e dëshmuar edhe nga:

³⁶ Po aty,

³⁷ Giuseppe CATAPANO, *Thoti fliste shqip*, v. 1983

- vendbanimet e Podgoricës,
- Vashtëmisë e Barçit në pellgun e Korçës;
- nga vendbanimi i Rashtanit e Rrajcës në rrethin e Librazhdit;
- nga vendbanimi i Blazit e Nezirit në luginën e Matit;
- nga vendbanimi i Burimit e Cetushit në luginën e mesme të Drinit të Zi-rrethi i Dibrës;
- nga vendbanimi i Kolshit në rrethin e Kukësit e shumë e shumë të tjera³⁸.

Këto vendbanime gjurmohen dhe thiren në kujtesë për fillimet e para të jetës në grupe dhe mikro qyteza, çka zbulohen nga niveli i veglave të punës, si ato prej stralli të Vlushës që janë të ngjashme me mikrolitet e shpellës së Konispolit dhe të Kryegjatës. Kurse jashtë territorit të Shqipërisë, simotrat e tyre i gjejmë në Sidari (Korfuz), në Crvena Sijena (Mal të Zi), si dhe në Copa Navigata e Terre Sabea (Itali e Jugut). Vendbanimi i Cetushit, ose siç e quajnë vendasit “Qyteti i Cetushit” gjendet pranë fshatit homonim, në krah të djathtë e buzë Drinit të Zi, rreth 6km në perëndim të qytetit të Peshkopisë.

Banimi dhe jetesa

Në truallin e Shqipërisë janë zbuluar disa dhjetëra vendbanime të periudhave të ndryshme të neolitit, që nuk kanë dallime, edhe me ato të zbuluara në trevat e Egjeut. Në trevën e Korçës janë zbuluar një numër, jo i vogël vendbanimesh neolitike³⁹. Duke u nisur nga venddodhja dhe shfrytëzimi i kushteve të terrenit mund të veçojmë tre tipa kryesore.

1. Vendbanime shpellore
2. Vendbanime të hapëta.
3. Vendbanime palafite.

Vendbanimet shpellore

Vendbanime bazë dhe si më të para, dhe të organizuara prej njeriut parak kanë qenë shpellat karstike, jo me pakicë në këtë trevë. Shpella karstike të banuara e të gërmuara janë shpella e Trenit, e Blazit, e Nezirit, e Dajçit, e Katundasit, e Velçës, e Bënjës, e Lengaricës, e Osumit, e Konispolit, e Pëllumbasit në skoran të Tiranës, e pa masë të tjera si këto.⁴⁰

³⁸ Myzafer KORKUTI, *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*, fq. 37, v. 2010

³⁹ Po aty,

⁴⁰ **Vetëm në zonën e Pukës sot, ndodhen jo më pak se 60 shpella**, pjesë të banesave fillimisht të pëllumbave, pastaj arinjve, pastaj e njerëzve e sot të lira apo të braktisura, as për studime ‘une e bare’.

Në luginën e Valit, në rrethin e Matit, gjenden shumë shpella karstike, disa prej të cilave janë shfrytëzuar për banim në kohën prehistorike. Në dy prej tyre, në shpellën e Blazit dhe të Nezirit, si rezultat i gërmimeve sistematike, ka qarkulluar arkeologjike, sa për të ndjekur zhvillimin historik të zonës së Matit në prehistori. Gjenden “punishte”, vend ku janë punuar veglat prej guri, sepse ashklat e gjetura janë të paretuara, material i mbetur nga procesi i përgatitjes së veglave. Për nga madhësia e forma, ato ruajnë tiparet e ashklave që përdoren për përgatitjen e veglave të epokës së Neolitit.

Vendbanimi neolitik i Rrajcës gjendet në fushën me të njëjtin emër, midis qytetit të Përrenjasit dhe Qafës së Thanës, rreth 200m në të majtë të rrugës kryesore automobilistike. Fillimet e jetës në shpellën e Dajçit lidhen me epokën e Bakrit. Karakteristike për kulturën e kësaj epoke është qeramika me parete të holla, e cilësisë së mirë, me ngjyrë të zezë e gri të zezë, ku dallohen enët biokonike, disa prej të cilave janë të zbuluara me kanelyra të pjerrta.


Vendbanimi i hapët

Vendbanimet e hapta bëjnë hapin e dytë të zhvillimit të njeriut parak, i cili me ngrohjen që pasoi pas ftohjes (25,000 deri në 18,000 vjet para krishtit), njeriu i at'hershëm, mbasi mbijetoi në skutet e errta në grupe të vogla doli në terren të hapur, por kësaj radhe më i madh në numër, më i organizuar e më i mencur, sepse ndërtimi i banesave kërkonte tru e mendje më tepër. Disa nga shembuj të tillë (Fig. - 6), të studiuara me skrupulitet prej prof. M.Korkutit, po i përmendim më poshtë si:

- **Konispol - III** - Mbështetur, kryesisht, në profilin e kuadrateve VIII e IX dhe në lëndën arkeologjike të përfutur, u arrit të veçohen tre faza sukseseve: III A – Neolit i hershëm, III B – Neolit i mesëm dhe III C – Neolit i vonë.
- **Velça** - Vendbanimi prehistorik i Velçës ose siç njihet nga vendasit, shpellat e Skotës, gjendet pranë fshatit të sotëm të Velçës, i cili ndodhet në shpatin perëndimor të malit të Gripës, në të djathtë të luginës së Shushicës, në rrethin e Vlorës.
- **Kultura e Vlushës**, si një kulturë tranzicioni nga Mezolitit në Neolit, sugjeron mendimin se procesi i neolitizimit të territorit të vendit tonë është bërë mbi një bazë kulturore vendase mezolitike.⁴¹

Nga 126 fshatra që ka Fieri, 38% e tyre janë të banuara nga e njëjta popullsi me zanafillë nga koha prehistorike. Sipas hartës arkeologjike, nga 53 fshatra të Mallakastrës, në 30 prej tyre janë hetuar e zbuluar mjaft materiale arkeologjike, si në Apolloni, Rreth, Libofshë, Mbyet, Adë, Maliq, etj.⁴² (Fig. – 7)

Fig. – 7 Banesa para historike në maliq të Korcës. Pamje nga gërmime, jo arkeologjike, thjesht në funksion të veprave urbane, siç ishte në vitet 40 tharja e kësaj kënetë për tu kthyer në tokë buke. Dukshëm bien në sy relike ose mbetje të një qytetërimi të organizuar njerëzor apo të një kulture tipike banimi dhe banesash, ku veç të tjerave kishte diga bonifikuese, etj.⁴³ (Gërmimet janë kryer nga Frano Prendi, ndaj dhe mirënjohja shkon për këtë arkeolog në zë).



Materialet arkeologjike të zbuluara në Cakran dëshmojnë për banorë të hershëm të kësaj zone. Në fshatin Cakran është zbuluar një vendbanim prehistorik që i përket periudhës së neolitit (7000 vjet para krishtit). Ndërtimi i banesave nga ana arkitektonike është bërë me dy faza. Faza më e hershme është ajo kur banesa futej e gjitha në dhë, ndërsa çatia dilte mbi sipërfaqe. Më vonë, për shkak të rritjes së depozitimit të dhéut është ngritur niveli i gropës.⁴⁴

⁴¹ Ndaj dhe thonë se Muzeu duhet të fillojë nga Vlushaj qysh 10,000 vjet, për shkak të një guri të palatuar.

⁴² Teki SADIKU, Mallakastra dhe Myzeqeja e vogël, fq.16, V.2009

⁴³ Po aty

⁴⁴ Ashtu si para ardhësit e tyre, pohojnë studius të tjerë, se popujt e trevës shqiptare, sot e më gjerë që kanë jetuar 5,000 vjet p.k, jetuan në mjaft qyteza apo bashkësi me popullsi të dendur, me tempuj të ndërtuar me baltra, ndonjëherë me lënd drusore dhe ndoshta me çati të sheshta.

Ndërtimet e banimeve palafite

Ngritja e vendbanimeve palafite (Fig. – 8) nënkuptonte një zhvillim e përsosmëri të teknikës së gdhendjes së drurit, siç i kemi të tilla në Dunavec që i përkasin mesit të mijëvjeçarit të pestë, e më pas në Maliq II që përkojnë me afërsisht mijëvjeçarin e katërt p.e.r.




Fig. – 8 Zonat e pakta të gërmuara dhe të zbuluara rastësisht, duke na dëftyer për një sërë kulturash të njëpasnjëshme, qysh nga paleoliti i vonshëm (vitet 30,000 parakrishtit) deri në prag jetës së qytetëruar⁴⁵.

Prerja dhe gdhendja e trarëve që përdorshin si pilota, si dhe mprehja e majave të tyre apo lidhja e pilotave me trarët e platformës horizontale, etj., përbëjnë disa nga elementët e mjeshtërisë së ndërtimit të këtyre banesave, por njëherësh edhe jetesë më të organizuar të shoqërisë, më të kulturuar, të cilët kishin kuptuar tashmë se puna në grup, mbrojtja në grup deri edhe ndonjë sulm në grup mund t'i sillte të ardhura më tepër.⁴⁶

Kultura e vendbanimit të Burimasit II, në tërësinë e tipareve që e karakterizojnë, i takon epokës së Bakrit, ndaj në vështrimin e përgjithshëm duhet të përfshihet në kulturën eneolitike të Maliqit (Fig.-8). Me fazën më të hershme janë lidhur mbeturinat e një vendbanimi palafit, i cili është dokumentuar nga qindra hunj vertikale, të vendosur pranë njëri-tjetrit, që kanë shërbyer për mbajtjen e platformës horizontale, mbi të cilën ngriheshin kasollet për banim. Vlen të vemë në dukje se majat e hunjve të palafitit janë të mprehura mjaft mirë, madje dallohen edhe gjurmët e sëpatave-dalta prej bakri. Në fazën Maliq II b, si rezultat i ndryshimeve të kushteve të terrenit, banesat janë ngritur direkt mbi tokë⁴⁷.

Gjetje dhe/ose përfundime

1. Për sa më sipër, këto janë fakte për të na dëftyer vazhdimin e jetës së njeriut parak europian (pellazge – ilire-thrake) në këto treva e më gjerë.
2. Tradita mezolitike në punimin e veglave të punë prej stralli në Vlushë, është dëshmia më e mirë e rolit autokton në formimin e kulturës së Neolitit të hershëm në Vlushë.

1.2.4.2 Kultura eneolitike

⁴⁵ Neritan CEKA, *The Ilirians to the Albanian*, fq. 25, v. 2005

⁴⁶ **Vetëm një nga rajonet shqiptare si Fieri sot përmban mbi 80 qendra**, ku përfshihen vendbanime prehistorike (Cakran, Lalar, Kutë, Mollaj, Plyk), qytete e kështjella protourbane e urbane, (Margëlliçi, Belishova, Drenova, Sfiri, Kolonja, Struma, Vajkani, Marinza, Gora, Usoja, Gruzeza), si dhe qytete ilire me tumat përkatëse, etj. Ato nuk janë thjesht vendbanime, por organizime deri në qytet shtete për derisa kishin prerje të monedhave, si në Cakran (Gurzeza), ku janë gjetur 3500 copë, Hoxharë 570 copë, Apolloni 2200 copë, Kreshpan 200 copë, etj. Thesare me monedha janë gjetur edhe në Patos fshat, Klos, Romës, Murxhit (Cakran), Libohovë, Margëlliçi, etj.

⁴⁷ Teki SADIKU, *Mallakastra dhe Myzeqeja e vogël*, fq.12, v.2009

Kultura eneolitike u zhvillua doradordhëm si një kulturë autoktone dhe në lidhje të ngushtë me kulturat bashkëkohëse ballkano-egjeane. Rreth mesit të mijëvjeçarit të tretë p.e.s., banorët e lashtë filluan të përdornin bakrin. Me përdorimin e tij filloi koha e bakrit ose koha e eneolitit (2600 deri 2000 vjet para e.s.).




Fig. - 9 Avlimendi ose tezgjahu, një ndër mjetet shumë të lashtë, i përdorur nga populli i trungut pellazg-ilir-thrakë.

Kjo shënon periudhën kalimtare nga koha e gurit në epokën e bronzit, me të cilën fillon koha e mirëfilltë e metaleve. Objektet e zbuluara në vendbanimet e eneolitit në kudo zonat e sipërmendura, si rrjetat dhe peshoret tregojnë për zhvillimin e peshkimit. Ndërkohë, peshoret flasin, si për tjerren, edhe për endjen me vegje vertikale (Fig. - 9), kurse enët prej balte flasin për zhvillimin e poçarisë (Fig.- 10). Njerëzit e kësaj kohe njihnin zbulimin e qeramikës me ngjyra dhe përdornin sistemin e numërimit *njëzetor* (*njëzet, dyzet, trizet, katërzet, etj.*).

Fig. - 10 Epoka e mesme e Bronzit - Poçe balte, Pazhok, viti 1500 para Krishtit. Poçeri të tilla janë të gjetura anembanë Mesdheut dhe Egjeut, çka tregon që një korridor urban kulturor si via Egnatia dhe via Tepelenë-Janinë ka bërë punën e vet. Gjithsesi, në gjithë këtë trevë, së bashku edhe me atë europian sot, nuk janë gjendur aq mijra vazo e poçeri, sa në treven e Fierit (Cakranit)⁴⁸.



Qeramika

Kultura e Bronzit të hershëm, si ajo e Maliqit nuk është diçka e re e ardhur dhe e depozituar mbi gërmadhat kulturore të një popullsie të mëparshme vendase, por përkundrazi një kulturë e lindur prej saj”. Në vendbanimin fqinj të Trenit IIIa, elementët që u trashëguan në fillim, si lyrat e bëra në enë me punim të trashë e pa finesë, si edhe teknika e gërvishtjes (inçizimit), janë dëshmi të tjera të ruajtjes së traditave eneolitike. Me vazhdimësi nënkuptohen përbërësit etnokulturor eneolitik, të cilët morën pjesë aktive në formimin e etnosit ilir gjatë epokës së Bronzit. Këta përbërës janë nyja lidhëse midis banorëve ilirë të epokës së Bronzit dhe banorëve të tejlashtë të epokës Eneolitike, të cilët u quajtën konvencionalisht Pellazgë.

Punimet e qeramikës dhe të poçerisë të kulturës neolitike në stacionet shqiptare sot (të Cakranit, p.sh)⁴⁹, që përbëjnë enët e ndryshme shtëpiake dhe objektet e kultit, kanë ngjashmëri e lidhje me kulturat neolitike të Egjeut, me ato të neolitit të mesëm të Italisë të zbuluara në pjesën Jugore të saj. Analogji, afërsi dhe paralelizma takohen edhe me kulturat neolitike të Dalmacisë e të Bosnjës.

⁴⁸ Teki SADIKU, *Mallakastra dhe Myzeqeja e vogel*, fq.13, V.2009


⁴⁹ Po aty

Ngjashmëria e enëve të kultit të Cakranit me objektet e kultit të zbuluara në zonat e Adriatikut e të Egjeut dëshmojnë më së miri për lidhjet kulturore e shpirtërore që kanë ekzistuar midis banorëve të këtyre krahinave. P.sh. pjatat e thella të qeramikës – një lloj tjetër ene kuzhine, nëse mund t'i quajmë kështu – të zbuluara në vendbanimin neolitik të Cakranit janë identike me ekzemplarë të gjetur jashtë vendit, si në Danilo, Smilçiç, dhe Elatea. Vendin kryesor të objekteve të zbuluara në Pojan e zinte punimi i qeramikës, e quajtur poçeri ilire, që ishte kryesisht me përkatësi ilire. Analizat e hollësishme tregojnë se mënyra e punimit të këtyre enëve, zbulurimi, trajtat e tyre, etj., janë me origjinë ilire. E tillë është ena e një vegjë të lartë e zbukuruar me pikturim, si dhe fragmenti i një ene tjetër me dy vegje me tyrup bikonik të fillimit të mijëvjeçarit të fundit p.k. Një enë e ngjashme me këtë është zbuluar edhe në fshatin vajzë të Vlorës, gjë që dëshmon për një kultutrë materiale midis taulantëve dhe amantëve që popullonin edhe trevën, ku ndodhej fshati Vajzë. Në shtresat kulturore të shek. VI p.Kr., të zbuluara në Apolloni janë gjetur me shumice fragmente të enëve prej qeramike, të cilat janë të poçerive të punuara nga mjeshtër ilirë që popullonin këtë vendbanim. Aty janë zbuluar, edhe disa peshore balte ngjyrë rozë e kafe, të cilat, sipas arkeologëve, ka shumë mundësi të jenë prodhuar dhe përdorur shumë herët nga banorët vendas ilirë.

Përfundime paraprake

- Me anë të pikturave në qeramikë si artet figurative, dekorative dhe arkitekturore kupton zhvillimin social dhe ekonomik deri arritjet në shkencë, ndaj dhe thuhet shpesh se shpikjet e njerëzimit janë kryer nga populli parak pellazg mijë vjet para se të hynin në skenë ata (të fortët) që shkruajtën historinë. (Fig. - 11)
- Në periudhën neolitike 6000 vjet para Krishtit, në kulturat Shqipëri e sotme dhe Egje gjenden qeramika antropomorfe, objekte kulti zanafillore, orendi të pikturuara me motive gjeometrike.
- Qeramika dhe zakonet fetare (kulti) janë elemente që tek popujt primitivë u janë nënështuar më pak ndikimeve.
- Qëndrueshmëria e këtyre elementëve provon vazhdueshmërinë etnike te grupet prehistorike.

Fig. – 11 Modeli gjeodetit që shkon sipas një modeli yllor te Argos. (Mirënjohje Robert TEMPLE⁵⁰)



Kuptimi i varreve

Një element të rëndësishëm për fillimet e kulturës neolitike është **kulti i varrimit** (Fig.-12) në truallin e banesës (pellgu i Korçës), i cili vazhdon gjatë Neolitit të mesëm (Cakran) dhe neolitit të ri (Maliq II)⁵¹. Në varre janë zbuluar epigrafe që përmbajnë shkrime në gjuhën mesape, që zbulojnë emra të përbashkët për të dy popuj të



⁵⁰ Robert TEMPLE, *The sirius mystery*, fq. 162, v. 1990.

⁵¹ Neritan CEKA, *The Ilirians to the Albanian*, fq. 25, v. 1990.

vendosur në të dyja anët e Adriatikut. Numri i madh i varreve të zbuluara në një nekropol të përbashkët, flet jo për një jetë shtegtare, siç pohon ndonjë historian i huaj, por për një jetë sedentare të bartësve të kësaj kulture. Nga të dhënat informative në rrethin e Fierit duhet të jenë edhe këto varreza tumulare në Frakullën e vogël, Vjosë (Ahmetbejas), Floq, Shën Gjergj, Kutë, Grishovë etj. Rrethi i Fierit është ndër rrethet e vendit që janë mjaft të pasura me varre tumurale.

Fig. - 12 Varret tumulare, teknologji tipike Ilire e varrosjes, e cila u përhap deri në gjermaninë apo austrinë e sotme. Varre të tilla të tipit Tumulus janë edhe ato të cilësuar ilire në Pazhok (Elbasan).

Tuma është ngritur në territorin që banohej nga fisi i bylinëve, pasardhësit e të cilëve janë banorët e sotëm të trevës së Mallakastrës. Nga 76 varre të zbuluara në tumën e Patosit, 10 prej tyre janë ndërtuar në epokën e bronzit të vonë.⁵²

Thyerja e enëve në varr ose gjatë ceremonisë së varrimit, e praktikuar gjerësisht në varret e tumës të Patosit, është një rit që sipas arkeologëve është përdorur deri vonë në shumë varre të zbuluara të vendit tonë.

Fortifikimet

Mbasi filloi të rritej mirëqënia e fiseve popuj, por edhe dalja në terren të hapët apo me palafite, por më tepër edhe në kujtim të mbrojtjes që kishin nga shpellat, njerëzit e asaj kohe menduan për fortifikimet. Filluan të nisnin luftrat, dhe nga shkaku i tyre, fiset filluan të organizoheshin ushtarakisht dhe t'i kthenin vendbanimet e tyre në qyteza-vendbanime të rrethuara në fillim me ledhe prej dhëu, dhe më vonë me mure prej guri, të cilat u quajtën *gurth* – *mure të gurtë të vegjël*, prej nga rrodhi fjala *gardh*, *garden*, *guard*, etj. (shih këtë fjalë në librin e dytë fjalorth). Një nga qytezat Ilire më të lashta të zbuluara është ajo e Gajtanit (Shkodër), e cila i takon shekullit XII para e.s. (Fig. -13). Prej fortifikimeve të pronave lindën qytezat e para të quajtura kala, në shembëlltje të karakterit të kafshës që sapo kishin zbutur (kalit) dhe që kishin kuptuar se ishte i fort, i ndershëm, i drejt.

Fig. - 13 Kalat apo qytezat e para të ngritura qysh në mijëvjeçarin e shtatë,⁵³ tipologjia e të cilave nuk ka aspak ndryshim me ato që janë ndërtuar në mijëvjeçarët pasues. Nuk ka fshat sot në trevën shqiptare, dikur qytezë, ku mos t'i gjenden rrënoja të një kalaje të tillë. Ose të gjitha kalave të sotme, (Berati, Lezha, Shkodra, Sopot, Butrinti, Borshi, Qeparoja, Himara, Gramshi) me patjetër dhe me pak gjurmë do të gjesh gure pellazgjik nën to, si dhe të njëjtin stil apo tipologji ndërtimi. (Mirënjohje Besir Bajramit)



⁵² **Tumat Ilire** gjenden deri në Nuremberg, që tregon shpërhapjen e tyre.

⁵³ Neritan CEKA, Udhëtim në Kështjellat Ilire, fq. 62, v. 2006

Kalatë apo kështjellat

Prokopi i Qezaresë është i pari, qysh në mesjetë që na la një dokument për kalatë shqiptare, dhe na jep 168 emra kalash të ndërtuara ose të rindërtuara në katër provincat vilajet të kohës së mesjetës. Ndërkohë, që më tepër se aq na jep edhe arkeologu i famshëm prof. Neritan Ceka dhe realiteti shqiptar na ofron më shumë se 2000 kala të tilla,⁵⁴ prej të cilave burojnë fshatrat e sotëm bazë. Prej tyre, fare fare pak kanë emra me origjinë latine ose greke. Gjithë të tjerët, populli i thëret si në krye të herës, ndërsa gjuhëtarët i konsiderojnë pjesërisht me etimologji ilire dhe pjesërisht me prejardhje të pazbërthyeshme.



Fig. - 14 Pamje nga kalatë në Borsh e Qeparo, por si të gjitha ato të tjera ngrihen mbi gure pellazgjik që tregon jetesën e popujve në mbrojtje nëpër maja malesh, pastaj në maja kodrash e sot në fusha e gjire detare.

Gjetje dhe/ose përfundime paraprake

Kalatë dhe qytezat protourbane përbëjnë material shumë domethënës për të gjykuar se:

- Ato (kalatë) janë tipikisht qytezat e para të qytetërimit pellazg ose atij europian;
- Janë të gjitha të një kohe (mijëvjeçari i tretë – dytë para krishtit), pamvarsisht se janë rrëzuar dhe ringritur në kohë të ndryshme, sipas pushtuesit të kohës;
- Fillojnë të gjitha me gurë ciklopi ose pellazgjik, sikundër kishat mbi ato bazilike dhe ato bazilike mbi ato pellazgjike (kisha në Dubrovnik, kisha e Kurjanit, Fier, Porta hyrëse e kalasë së Beratit, etj.);
- Ato kala na tregojnë se në fund të Antikitit, popullsia e këtyre provincave nuk ishte e romanizuar.
- Janë të gjitha ose kanë qenë të banuara, pra në rolin e një qyteze të mbrojtur, siç janë ende sot kalatë e Beratit, Ulqinit, Shkodrës, Gjirokastrës, Lezhës, Lefkadhës (kalaja e Lekës të madh – Lek/Aleksandri/leka dhe ada, turqisht/kala, gjë e ngritur).
- Edhe kur nuk kemi të bëjmë me kala, ato janë vendbanime të vendosura në kodra të buta e tarraca lumore e në lugina pjellore, buzë lumenjve e kullotave të mira, si Podgoria, Burimi, Kolshi, Vilë Boshtova, etj. (Fig. – 14)

⁵⁴ The Reader's Digest Association, *The last two milion years*, fq. 45, v. 1973

- *Mokrat e gurta për bluarjen e drithit, si dhe balta në formë llaçi e përgatitur nga byku i përzier me dhé që përdorej për shtruarjen e dysHEMEVE dhe suvatimin e mureve, ka qenë traditë në trevën e toskërisë e më gjerë qysh nga neoliti, pasi në të dyja rastet janë përdorur deri vonë para çlirimit.*
- *Tipar tjetër i kësaj jetese ishte karakteri civil i saj, ku popullsia nuk shtrihej e shpërndarë nëpër ara dhe nuk banonte në kasolle, por në banesa të qëndrueshme.*
- *Rasti i Kolshit e Cetushit përbëjnë shembuj të vendbanimeve që kanë shfrytëzuar kushtet që ofron terreni për mbrojtje.*
- *Vendbanimet shpellore janë vetë kala, si Neziri, Blazi, Katundasi, Treni, etj., të cilët gjithashtu janë vendosur në lugina e vende me kushte shumë të favorshme natyrore.*
- *Jo rastësisht, emërtimet e dala për qytetet e rrethuara janë të lidhura domosdoshmërisht me shpjegime me anë të shqipes, si: kala që vjen nga fjala kal që kishte dalë si emërtim për kafshën e zbutur, por të fortë kal, me kuptimin që të mbron.⁵⁵*

1.3 NJERIU SAPIENS SAPIENS

1.3.1 Lindja e njeriu sapiens sapiens (dy herë i ditur)

Njeriu sapiens i kësaj kohe, diku 6000 deri në 5500 vjet para krishtit ka shumë të ngjarë, për shkak të përballjes me katastrofat natyrore të ketë dalë ngadhnjes ndaj tyre, sepse siç e thamë më lart, ai studioi ligjësitë e natyrës qiellore dhe tokësore deri te lëvizjet e kafshëve apo zbutjen e tyre. Ndryshimi i doradorshëm i tyre, edhe për shkak të përmirësimit të strukturës së ushqimit mesdhetar e bëri atë ‘*dy herë më të mencur*’, ose shumë më të zhvilluar, ku i kishte prekur pothuajse shpikjet që ne zotërojmë sot, aq sa mendohet ose kemi një hop në zhvillimin e trurit të tij ose kemi një kryqëzim me UFO-t e ardhur nga lart.

1.3.1.1 Njeriu parak european ose pellazgian

Është koha kur raca ariane u bë zot i mesdheut, duke shërbyer si mburojë në mbrojtje të tij. Është koha, kur ende nuk ishin shkëputur baskët, galët, keltët dhe as nuk ishin krijuar sumerët, babilonasit, asirët dhe egjyptianët. Ishte ky bashkim dhe kjo gatitje apo ky zhvillim i këtij njeriu të mbijetuar që arriti të përballonte dhe të ndalonte furinë e komuniteteve, si ata me ngjyrë nga Saharaja, apo nga jugu i jugut të Egjyptit dhe ata mongoloid nga Azia, për shkak të ndryshimeve të klimës që po ndodhte në këto zona (jo më kot i shpjeguam më sipër).

Përballja dhe ndalimi që i bën kësaj mësymje, përbën borxhin e parë që njerëzimi european i ka racës ariane-pellazge. Pas zotërimit fizik që i bën mesdheut, tani ky komb filloi të mendonte sesi të zhvillonte vetveten, shoqërinë, marrëdhëniet në punë deri në sigurimin e produkteve të jetesës.

1.3.1.2 Shtrirja e njeriut parak european ose pellazgian

⁵⁵ **Simbolika e Kalit** - Dihet që simbolika e kalit është që kurrë nuk ndodh që të të zërë poshtë, pra të mbron, por edhe për faktin i fort. Ndaj e mori dhe një qytet i rrethuar këtë kuptim kala, që ne e përdorim kaq thjesht edhe sot. Por, edhe fortesë qoftë ka kuptimin nga shqipja prap, sepse “i, e fort” është fjalë tipike njërrrokshe shqipe. Gjuhët e tjera e kanë dy rrokje forte, ose fortress. Ju kujtomë se në Kretë ka qytet ende sot që quhet apo thëret Rrethmo. Më fjalë tipike shqipe ‘rreth apo rrethim’ nuk ka ku gjendet.

Është pranuar prerë se pellazgët, ilirët, thrakët, thesalianët e parë zinin këtë krahinë që në periudhën e Neolitikut, ndërkohë që janë këtu qysh prej ciklit të fundit akullnajor (25,000 vjet më parë). Paleontologët pohojnë se ky territor i stërmadh ka qenë i banuar qysh në fillim të Kuaternarit të sotëm ose anthropocenit, më sakt kohë që përkon me Holocenin, pra diku 10-12,000 vjet para krishtit. Homo sapiensi, sigurisht, ka shkelur në tokën e këtij rajoni prej nga u shfaqën banorët e parë të Europës të njohur si njerëz parak, të ardhur nga koha që s'mbahet mend, prej abisaleve të mijëvjeçarëve pelarg ose pellazgë. Këta përbëheshin prej Ligurëve = me lëkurë, njeri i mbuluar me lëkurë; prej Iberëve = i parë, nënkupton të parët që lanë grupin pellazg stërgjyshor për tu vendosur në gadishullin që do të bëhej i Iberëve; Frigjianëve = të ikurit nga frika pas përmbytjes, Lisianëve = liqen, popull i detit i liqenit ose thjesht i ujit të vendosur rreth liqenit të Ohrid. E gjithë kjo familje e fiseve pellazge⁵⁶ ka krijuar degën thrako - ilire.

Shqiptarët apo Pellazgët e at'hershëm jetonin deri në Kaukaz, që njihet si vendi me historinë më të vjetër të njerëzimit, në afërsi të të cilëve edhe Nuhi e groposi Arkën e tij për vazhdimësi të jetës në tokë. Që atëherë e deri më sot, pas dyndjes së madhe të popujve, një pjesë e pellazgëve luajti rol kyç në formësimin, lidhjen dhe rrjedhen e popujve të rinj, kurse bërthama pellazgjike apo ADN-ja e qenies pellazgjike për ta ruajtur origjinalitetin e vet, u tkurr në të dyja anët e tokës së tyre, të tërhequr në male për një periudhë shumë të gjatë, ku njëri vend është Albania e sotme, tjetri është në anën e kundërt të territorit të tyre, Albania kaukaziane (Fig.-15). ADN-ja e tyre është përhapur edhe nëpër kombet e tjera të krijuara më pas nga popujt bazë, një nga të cilët ishin pellazgët. (Tab. -1)

Fig. – 15 Popujt e parë të mbas fillimit të jetës jashtë shpellave që ngjizën shtetet dhe kombësitë përkatëse, të cilat mbrritën deri në mesjetën e vonshme para fillimit të rilindjes europiane, ku origjina e parakëve europianë u



tradhtua, duke sajuar histori të reja apo të tjera.
(Mirënjohje akademikut prof.dr. Edi Pingulit)

1.3.2 Qytetërimi eneolit

Qytetërimi eneolitik i zonave ilire të Maliq II vijon pa shkëputje nga qytetërimi neolitik bazuar në të dhënat antropologjike dhe paleontologjike.

Tab. – 1 Popujt me bazë popullin parak (pellazg, parailir, protoilir,) të formuar në mijëvjeçarët e tretë

pra njerëz të pjellë me tru, citim te libri i vet 'Shqipeja përtej

PELLAZGËT			
POPULL PARAHELEN MADJE PARAHISTORIK			
Emri i Fiseve të dalë nga i njëjti			
Trung Etno - Kulturor			
Nr.	DEGA PERËNDIMORE	DEGA EGJEASE	DEGA LINDORE
	ILIRËT	LELEGËT	THRAKËT
1	Thesprotët (Epirotët)	Karianët	Frigjianët
2	Mollosët	Lisianët	Trojanët
3	Kaonët	Kretasit	Moskët
4	Dodonët	Lesbionët	Lidianët
5	Thesalianët	Egjeanët	Mizianët
6	Argianët	Popujt të Detit	Etruskët
7	Dardanët	Jonianët	Maqedonët
8	Panonianët	Periekët	Getët
9	Venetët	Hilotët	Dakët
10	Liburnët	Penestët	Hititët (Prijësit)
11	Dalmatët...		Girgashitët (Palestinë)
12	Mesapët		Jebuzianët (Palestinë)
13	Japigët		Kaukazianët (Thrakët)
14	Daunianët		Shqiptarët të Kaukazit
15	Ligurët		Armenë (Frigjianë)
16	Iberët (Gadishulli Iberik)		Burshush (Afganistan)
17	Baskët		Disa etni minoritare në Azerbaixhan, etj.
18	Galët		
19	Keltët		
20	Arvenët		
21	Druidët		
23	Filistinët (Ilirë të vendosur në Palestinë)		

*Jonianët (Pellazgë autoktonë të kthyer në helenë) pasi kanë mësuar Greqishten sipas Hekate, Herodoti, etj.)

*Penestët (etni ilire autoktone të nënshtruara nga Dorianët.

dhe të dytë deri në periudhën e para dhe pas luftës së Trojës.⁵⁷

1.3.2.1 Revolucioni i parë neolitik

Përparimi në Epokën e Re të Gurit ishte i një rëndësie aq të madhe, sa i është dhënë emri Revolucion Neolitik, dhe asnjë revolucion tjetër nuk ka qenë kaq afër me produktet e tij, sa ky revolucion. Bujqësia prodhonte më shumë ushqim, dhe si rezultat pati një rritje të shpejtë në numër të njerëzve. Ata filluan të grumbullohen së bashku dhe të krijonin qytet-shtetet e para. Rrjedhat ujore natyrore u riorganizuan dhe u hapën kanalet ujitës. Kasollet u riorganizuan në fshatra dhe më vonë në qytete. Qerret plugonin dhe tërhiqnin karrocën. Njeriu u gatit në atë gjëndje sa të krijonte kushte, në të cilat kafshët dhe bimët mund të përhapeshin përtej vendit të tyre original, duke shtuar numrin e tyre, dhe madje duke i ndryshuar fizikisht ato në shërbim të vetvetes. Në botën e vjetër parahistorike, shumë prej hapave thelbësorë që u morën në revolucionin bujqësor, ishin midis viteve 10,000 dhe 5,000 p.k. në një zonë që shtrihej nga Nishi i Serbisë sot (paraleli një) deri në Tebë, jugu i Egjiptit (paraleli shtatë) dhe nga Tomorri (perëndim) deri në Krime (lindje). Kjo dëshmohej edhe nga trekëndshi barabrinjës që zinin vend të parët europianë ose pellazgët, njerëzit e ardhur *pe larg*, ose *pe lart*.⁵⁸ (Fig. -16)

Kujdes! Në interpretimin tonë, prej larg nuk është, siç e dëshmojnë shume syresh, se ata (pellazgët) erdhën nga veriu, nga veri lindja apo nga Norvegjia se ishin leshverdhë e sy blu, siç nordikët janë sot. Hajde shpjegim hajde?! Interpretim më mekanik, më dembel dhe më të papërgjegjshëm, zor se gjen. Jo të dashur lexues, koncepti pellazg nuk lidhet kaq thjesht pas emrit si *pe larg*, *pe leshi*, *pe pylli*, etj., etj., por:


- *së pari, larg do të thotë që vijnë nga thellësitë e mijëvjeçarëve që iu shpëtuan ngjarjeve të mëdha e katastrofave natyrore, si akullnajimit, hirit vullkanik dhe përmytjes.*
- *së dyti, ngjyra e flokëve dhe e syve lidhet me fuqinë e diellit që ishte at'herë, sikundër është sot në vendet nordike. Dhe ngrohja globale sposto paralelet e të ftohtit apo të ngrohtit deri aty ku ndodhet sot.*

Fig. – 16 Matjet gjeodezike në tokë, duke na treguar distancat midis yjeve kryesorë në qiell, njëherësh dhe vetë shtrirjen e trevës me pellazgë. (Mirënjohje Robert Temple).

1.3.2.2 Metali - zbulimi që ndryshoi botën

Revolucioni i dytë botëror industrial

Bakri, bronzi dhe hekuri, fillimisht u përdorën në Azinë perëndimore, duke siguruar mjete të forta dhe një klasë e aftë prej tyre, si ajo e farkëtarëve krijuan revolucionin e parë botëror industrial. Një proces, i cili do të kishte pasoja për të gjithë njerëzimin, filloi ndërmjet një grupi zejtarësh në Azinë perëndimore, diku rreth 8000 vjet më parë. Ky ishte zbulimi i metal-punuesit, i cili më në fund



⁵⁷ Sipas studimeve të Akademikut prof. dr. ing. Edi PINGULI

⁵⁸ Robert TEMPLE, *The sirius mystery*, fq. 170, v.1998

do ta nxirrte njeriun nga jeta e gjatë e Epokës së Gurit. Përdorimi i metalit, fillimisht është zbuluar në treva që lidhen me Iranin e sotëm dhe Turqinë perëndimore, e cila pa dyshim at'herë ishte Hittite, pra, pellazge rreth 6000 vjet p.k. Pas disa shekujve, sipas enciklopedisë botërore,⁵⁹ banorët e mesdheut lindor dhe ata në Turqinë jugore shkrinin si bakrin, edhe plumbin.

Epoka e Bronxit

Epoka e bronzit përfshin gjithë mijëvjeçarin e dytë. Gjatë kësaj kohe, vegla e punës dhe armët prej guri u zëvendësuan pak nga pak: në fillim me ato të përgatitura nga bronzi dhe më vonë nga ato të hekurit.

Teknologjia e nxjerrjes dhe përpunimit të bakrit, si dhe përgatitja e veglave të punës me materialin e ri sollën ndryshime në marrëdhëniet brenda gjinisë. Ato nxorën në plan të parë rolin e burrit, çka pati si pasojë fillimin e organizimit të një shoqërie të re fisnore patriarkale.

Struktura e furrave - Në vendbanimin e Maliqit e të Kamnikut janë fiksuar furra me planimetri katrore, me qoshe të rrumbullakuara dhe furra në formë patkoi. Poçaria e vendbanimit të Podgoricës I, për nga cilësia, mund të krahasohet me realizimet më të mirat e poçarisë së Thesalisë e Anatólisë. Fakti që rrënojat e dysHEMEVE me baltë të pjekur, të gjetura në vendbanimin e VlUSHËS (Skrapar), janë të përziera me byk e kanë të stamposur farëra drithërash, dëshmon qartë se bartësit e kulturës së VlUSHËS, qysh në periudhën e tranzicionit nga Mezoliti në Neolit, njihnin dhe kultivonin drithërat.

Në metalurgji, me daljen e bronzit, u shënuan përparime në përgatitjen e veglave të punës e të armëve, kurse në organizimin shoqëror u vendosën marrëdhëniet patriarkale. Në territorin e vendit tonë, Bronzi i hershëm është dëshmuar mjaft mirë arkeologjikisht nga vendbanimi i Maliqit (Maliq III, a,b), i Trenit (tren II, a), i Gajtani I, si edhe nga varret më të hershme të tumave të Pazhokut, të Barçit, etj.⁶⁰

Krijimi i një kombi

Ky revolucion, sigurisht që pruri marrëdhënie të reja në prodhim, çka solli nevojën e bashkëpunimit me ligje e rregulla. Kësisoj, njerëzit e asokohe u bënë të lashtë e parë që arritën ekzistencën kombëtare në një botë, ku principatat e vogla dhe qytet-shtetet ishin modeli i shoqërisë.

Emblemat e madhëstisë

Ky popull i bërë komb e ndjente se popujt apo njerëzia e ardhshme do të lakmonte modelin shtet të tij, kulturën, shkrimin, bollëkun dhe shtatë artet e tij. Ndaj, i përjetësoi ato në emblema të fuqishme si në:

1. Gurë ciklopik,
2. Piramida,
3. Kala ose fortesa,
4. Shkrime në hieroglifë,
5. Varrosje e balsamuar.

Për t'i mbajtur gjatë e gjallë këta elementë, këtij populli parak apo këtij kombi i duhesh një besim, dhe brenda tij një fshehtësi e caktuar, të njohura si elementët mistikë të besimit pellazg, siç janë:

⁵⁹ The Reader's Digest Association, *The last two milion years*, fq. 52, v. 1973

⁶⁰ Myzafer KORKUTI, *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*, fq. 200, v. 2010

1. Besimi;
2. Gjuha;
3. Shkrimi;
4. Njohuritë astrologjike;
5. Matematika-gjeometria;
6. Ndërtimi;
7. Organizimi shoqëror në fise;
8. Trashëgimia kulturore.

Janë këta komponentë emblematic dhe elementë mistik të besimit pellazg që vazhduan, me dhe pa ndërprerje rrugëtimin historik drejt popullit të sotëm e të vetëm të këtij trugu, siç është ai shqiptar.

1.3.3 Zhvillimi dhe rënia e civilizimeve të vjetra dhe të reja

Afërsisht 4000 vite më parë, ka shumë mundësi që ndryshimet e klimës të kenë çuar në shkatërrimin e civilizimeve të ndryshme, siç janë ato të Harappa dhe të Akkadia dhe që ishin gjithashtu, këmbëzat për themelimin e civilizimeve të reja, të cilat u zhvilluan përgjatë bankove të lumenjve të Nilit, Eufratit dhe të Tigris. Shkretërimi i Saharasë duhet të ketë përbërë, gjithashtu një faktor të madh në emigrimin e disa komuniteteve nga Afrika e Veriut për në Evropën me lagështi. Megjithatë, janë akoma në diskutim shkaqet e sakta të ndryshimit të klimës, diku pas mesit të Holocenit, (4000 vjet para krishtit) në lidhje me lindjen dhe zhdukjen e civilizimeve të vjetra. Sipas disave, lagështia inkurajoi zhvillim ekonomik dhe social. Sipas të tjerëve ishte ariditeti, ai që i detyroi komunitetet e para civile që të krijonin përgjatë brigjeve të vlefshëm të lumenjve popullsi të dendura dhe të qëndrueshme.⁶¹ E përmendëm këtë civilizim nga më të hershmit e shoqërisë njerëzore për lidhjet që ai ka pasë me botën pellazgjike, me gjuhën, me aftësitë e zejtarisë, me të drejtën zakonore⁶² e me shumë elementë të tjerë biometrikë të këtij trugu, siç do ta shikoni të dashur lexues në faqet e këtij libri dhe ata shoqëruar të tij.

⁶¹ **P.sh., disa kanë sugjeruar se deri 4000 vite më parë se krishti, lagështia iu ka lejuar Harappa-ve të ndërtonin një qytetërim urban të rëndësishëm në luginën Hindus, ku bujqësia e tyre varej nga vaditja në mënyrë që të lulëzonte. Harappa dhe Mohenjo-Daro ishin qytetet kryesore të këtij civilizimi, që zgjati më shumë se pesë shekuj dhe pastaj u zhdukën rreth 4200 vite më parë. Mendohet që kjo zhdukje të jetë për shkak të kripëzimit të fushave të tyre ose për shkak të shirave të dobësuar musonik, që shkaktuan në këtë zonë arritjen e pragut më të ulët që duronte ariditetin. Disa shkencëtarë besojnë ndryshe, d.m.th. se ky civilizim i Luginës Hindus u zhvillua përgjatë bankove të lumit, vetëm pasi ishin tharë liqenet e asaj zone. Gjithashtu, disa, zhdukjen e Perandorisë Akkadiane, e cila pushtonte krahinën që sot njihet me emrin Irak, ia veshin një episodi të papritur dhe të madh të ariditetit, që e shkatërroi bujqësinë e tyre 4000 vite më parë se lindja e krishtit. Paqëndrueshmëria klimatike që u shfaq 6000 vite më parë, me frekuencën e saj më të madhe të thatësirës dhe e një pranije më të fuqishme të kushteve të El Ninos, kontribuuan në lindjen e kulturave të ndryshme, të cilat ishin më vitale dhe më të lulëzuara sesa ato që erdhën para tyre. Gjatë episodit, ngritja e nivelit të detit ishte 15 cm/ditë dhe bëri që vija bregore, në disa zona, të kapte qindra metra për një ditë. Diskutohet ende nëse kjo katastrofë natyrore është burimi mbi mitin e 'Përmytjes së Madhe', dhe se kjo përmytje e botës i dha shtysë zgjerimit të bujqësisë në drejtim të Evropës Qendrore, për shkak të emigrimit të popullsisë, që më parë banonin në brigjet e liqenit. Kohët e fundit, me ndihmën e robotëve nënujorë, oqeanografi Robert Ballard gjeti tregues të popullsisë të hershme njerëzore në zonat që tashmë janë të mbuluara nga Deti i Zi.**

⁶² **Gjergj FISHTA, Parathanë në Kanuni i Lekë Dukagjinit, fq. 5-7, ku përfundon se ka mundësi që Kanuni të ketë qenë i kodifikuar, sepse nuk mund të shpjegohen ndryshe analogjitë e shumta që Ligjet e Kanunit kanë me Ligje të Romës, të Bizantit, të Serbisë.**



“RRËNJËT TONA”